



NGA BUXHETIMI TEK NDIKIMI:  
**PRAKTIKA TË MIRA  
KOMUNALE NGA  
POLITIKËBËRJA  
DHE BUXHETIMI I  
PËRGJEGJSHËM GJINOR**

## KOMUNA E MANASTIRIT

# THYERJA E BARRIERAVE: NJË RRUGË DREJT BARAZISË

**B**eti Bullakovska (49), Lidija Veljanovska (42) dhe Simona Jovevska (35) ndajnë një luftë të përbashkët - duke lundruar në një botë që shpeshherë nuk i kushton vëmendje nevojave të tyre për shkak të paaftësisë së tyre. Për Simonën, mungesa e aksesit fizik nuk është thjesht një shqetësim, është një kujtim i përditshëm i përjashtimit. “Pa akses fizik, do të mbeteni pas, në fund të shkallëve përballë ndërtesës”, thotë Simona, duke i bërë jehonë ndenjave të shumë njerëzve në situata të ngjashme.

Në Komunën e Manastirit, 1400 qytetarë me aftësi të kufizuara ballafaqohen me sfida të qasjes fizike që i pengon të kenë qasje në objektet e Komunës, institucionet kulturore dhe arsimore, kopshtet, shkollat, vendet e punës dhe shtëpitë. Barrierat për përfshirjen e plotë sociale dhe ekonomike përfshijnë nevojën për mjedise fizike të aksesueshme dhe mundësi transporti. Prandaj, për të garantuar barazi për të gjithë qytetarët, përshtatja e buxheteve kombëtare dhe vendore përmes buxhetimit të përgjegjshëm gjinor mund të ndihmojë në kapërcimin e disa prej këtyre sfidave, duke reduktuar gjithashtu pabarazitë strukturore ndërmjet grupeve të ndryshme sociale.

Me njohjen e seriozitetit për çështjen, Komuna e Manastirit bëri një hap të madh përpara në vitin 2021, duke ndarë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të saj - 11 milionë denarë - drejt çmontimit të barrierave dhe nxitjes së gjithëpërfshirjes.



Kjo nismë, e quajtur “Ndërtimi i urave”, kishte për qëllim të riformësonte peizazhin komunal duke ofruar akses fizik në institucionet, shtëpitë dhe rrugët përreth Komunës, duke siguruar që qytetarët si Beti, Lidija dhe Simona të mund të lëviznin nëpër qytetin e tyre me dinjitet dhe lehtësi, dhe se aksesit nuk është privilegj, por e drejtë. Në përputhje me Agjendën për zhvillim të qëndrueshëm 2030, Manastiri pohoi përkushtimin e saj për të siguruar që aftësia e kufizuar nuk do të shërbejë kurrë si pengesë për zhvillimin apo të drejtat e njeriut. Përpyekjet e komunës adresojnë nevoja të ndryshme. Nga subvencionet për përshtatjen e shtëpive, madje për shkollat dhe institucionet kulturore të aksesueshme, rregullimi i konviktit të studentëve, parkimi falas për qytetarët me aftësi të kufizuara, çdo masë ka në vete prioritet barazinë. Komuna në vitin 2024 vazhdoi ndarjen e mjeteve për rregullimin e infrastrukturës, duke caktuar 510 mijë denarë shtesë për këtë qëllim.

Për Betin, Lidijen dhe Simonën, këto masa nuk janë thjesht politika – ato janë linja shpëtimi, që rikthen besimin në vetvete dhe mundësojnë momente si ceremonia e martesës së Simonës brenda ambienteve të komunës. Duke i dhënë prioritet gjithëpërfshirjes, Manastiri nuk ndërton vetëm infrastrukturë, por kultivon një kulturë fuqizimi, ku çdo qytetar ka zë në formësimin e së ardhmes së tij. Megjithatë, rrugëtimi drejt përfshirjes së plotë vazhdon. Në Manastir, me çdo masë të buxhetuar, rruga drejt barazisë nuk është një ideal i largët – ai është një realitet i prekshëm, i farkëtuar përmes bashkëpunimit, dhembshurisë dhe angazhimit për të ndërtuar një komunitet më të mirë për të gjithë.

Foto: Falë dashamirësisë të Komunës së Manastirit





## KOMUNA E NOVACIT

# NGA QENDËR DITORE NË KOPSHT FËMIJËSH: MBËSHTETJA E NËNAVE QË PUNOJNË NË NOVACI

**M**arija Simovska Trajçevska është nënë e përkushtuar e dy djemve nga Komuna e Novacit. Ndërsa pushimi i saj i lehonisë për djalin e saj më të vogël i vjen fundi, ajo përballet me realitetin dekurajues që duhet të kthehet në punë së shpejti. Duke qenë se askush nuk është në dispozicion për t'u kujdesur për djalin e saj gjatë ditës, ajo përballet me sfidat e balancimit të detyrave të saj të nënës me përgjegjësitë profesionale. Për Marijanë dhe nëna të tjera të panumërta në komunitetin e saj, mungesa e infrastrukturës adekuate të kujdesit për fëmijët jo vetëm që ndikon në aftësinë e tyre për të punuar, por gjithashtu rëndon shumë në mendjet e tyre ndërsa përpiqen të sigurojnë familjet e tyre gjatë rritjes së fëmijëve. "Jam e bindur që nënat janë të papuna jo për mungesë mundësish, por për mungesën e dikujt që të kujdeset për fëmijët e tyre të vegjël" – thotë Marija.

Komuna e Novacit në dhjetë vitet e fundit ka pasur një çerdhe për fëmijë, i cili më parë ofronte shërbime përkujdesjeje vetëm për dy orë e gjysmë çdo ditë. Banorët, veçanërisht gratë, kanë kërkuar që Komuna të hapë një kopsht të vërtetë që do të ofrojë kujdesin e nevojshëm pedagogjik të përditshëm për fëmijët. Gratë që jetojnë në zonat rurale, si Komuna e Novacit, ku bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave, shpesh punojnë tetë orë ose më shumë çdo ditë. Pavarësisht përpjekjeve të tyre të palodhura, mungesa e shërbimeve të kujdesit për fëmijët kufizon ndjeshëm aksesin e tyre në mundësitë e punësimit.

Foto: Falë dashamirësisë të Komunës së Novacit



Duke njohur nevojat urgjente të nënave si Marija dhe komunitetit më të gjërë, Komuna e shndërroi qendrën ditore “Bambi” në një kopsht fëmijësh të pajisur plotësisht. Qëllimi i kopshtit është të sigurojë një qëndrim ditor tetë-orësh (përfshirë ushqimin, një program pedagogjik dhe shërbime të tjera) për 50 fëmijë të moshës dy deri në gjashtë vjeç. Për ta bërë këtë realitet, nga buxheti komunal janë ndarë 5,2 milionë denarë. Nga njëra anë, hapja e kopshtit “Bambi” në vitin 2020, pas disa vitesh rikonstrukcioni, rriti vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e nënave kur u regjistrua grupi i parë i fëmijëve. Nga ana tjetër, kjo nismë do të rezultojë në përmirësimin e zhvillimit të fëmijëve, pajisjen e tyre për vitet e ardhshme shkollore, duke kontribuar në një dinamikë më të mirë familjare dhe në përgjithësi, në dobi të gjithë Komunës së Novacit. “Më vjen mirë që Komuna i ka marrë parasysh prioritetet për të cilat kemi folur për shumë vite dhe ka marrë vendimin e duhur – të ndajë mjete për hapjen e një kopshti.

Ky ishte një lehtësim i madh për mua, sepse pushimi im i lehonisë po përfundonte dhe do të më duhej të kthehesha në punë. Kjo do të thoshte një shqetësim më pak për mua dhe besoj se do të nënkuptojë të njëjtën gjë për nënat e tjera në situata të ngjashme” – tha Marija.

Shndërrimi i Qendrës Bambi në një kopsht fëmijësh do të ketë një ndikim të thellë te Marija dhe shumë nëna të tjera, si dhe miqtë, familjen dhe fqinjët e saj. Me këtë përmirësim, ata të gjithë do të përfitojnë nga një mundësi e besueshme dhe e aksesueshme e kujdesit për fëmijët, për të vegjlit e tyre. Komuna po kërkon mënyra për të rritur numrin e fëmijëve që mund të ndjekin kopshtin. Hapi i parë drejt kësaj është që prindërit e punësuar nga Novaci të regjistrojnë fëmijët e tyre në “Bambi”. Hapi tjetër është vlerësimi i mundësive për të përfshirë më shumë fëmijë nga fshatrat përreth.



## KOMUNA E KOÇANIT

# “SË BASHKU KUJDESEMI” SHËRBIMI MOBIL PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SOCIAL

Shumë qytetarë të moshuar jetojnë në zonat rurale dhe të largëta të Komunës së Koçanit me qasje të kufizuar në shërbimet e nevojshme të kujdesit mjekësor dhe social. Për shkak të vendndodhjes gjeografike dhe të paarritshme të shtëpive të tyre, shumica e tyre, veçanërisht gratë, nuk kanë akses në shërbimet bazë sociale dhe shëndetësore. “Unë jetoj vetëm me gruan time në shtëpinë tonë të fshatit. Fëmijët tanë janë larguar nga fshati dhe nuk kemi kush të kujdeset për ne, të na ndihmojë” - ka thënë një vendas me banim në zonat rurale të Komunës së Koçanit.

Duke njohur rrethanat me të cilat u përballën shumë qytetarë, Komuna mori vendimin për të formuar një ekip shërbimi mobil, i ngarkuar me ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore drejtpërdrejt në shtëpitë e banorëve të fshatit. Ekipi përbëhet nga katër infermiere dhe dy nëpunës socialë dhe udhëhiqet nga një koordinator i caktuar nga komuna. Ajo funksionon në tri komuna: Koçan, Çeshinovë-Obleshëvë dhe Zërnovc. Përveç ofrimit të shërbimeve parësore, ekipi identifikon në mënyrë aktive individë dhe familje në zonat rurale që kanë nevojë për mbështetje institucionale dhe i ndan këto të dhëna thelbësore me Komunën për të lehtësuar planifikimin dhe përpjekjet e ndërhyrjes në të ardhmen.



Gjatë viteve 2020 dhe 2021 ekipi ka ofruar edhe rekomandime për qytetarët në izolim, masat higjienike që duhen zbatuar, identifikimin dhe monitorimin e simptomave të COVID-19, informimin e kategorive të qytetarëve që janë në rrezik të infektimit për masat e nevojshme për mbrojtjen nga virusi, dhe sigurimin e kontaktit të drejtpërdrejtë me mjekët e familjes së pacientëve. Me këtë shërbim mobil, Komuna vendos një model të ri për shërbimet sociale dhe shëndetësore për qytetarët që jetojnë në zona të paarrishme dhe të largëta dhe përballen me sfida sociale, ekonomike dhe shëndetësore.

Në vitin 2021, 50 mijë denarë nga buxheti komunal për shërbime sociale, për fëmijë dhe shërbime shëndetësore janë ndarë për funksionimin e shërbimit mobil, me qëllim zgjerimin e tij në vitin 2023. Spitali komunal po siguron pajisjet e nevojshme mjekësore. Nga themelimi i tij deri në vitin 2024, ekipi u shërbeu 2067 pacientëve (742 burra dhe 1325 gra), ndihmoi të paktën 1648 familje dhe identifikoi rreth 350 familje me rreziqe specifike shëndetësore dhe sociale. Pacientët e shërbimit mobil shprehen kënaqësi që institucionet nuk i kanë harruar, edhe pse jetojnë jashtë qytetit.

“Kjo është një nga gjërat më të mira që na ka ndodhur. Ne u jemi mirënjohës njerëzve që e kuptojnë se kemi nevoja, që kërkojmë ndihmë dhe se dikush është i gatshëm të na dëgjojë. Do të thotë shumë për ne”, tha një pacient i një shërbimi mobil. Në ditët e sotme, shërbimi është zgjeruar për të moshuarit në shtëpitë e tyre, me një ekip prej 16 kujdestarësh femra që ofrojnë shërbime mbështetëse.

Me këtë shërbim mobil, Komuna vendos një model të ri për shërbimet sociale dhe shëndetësore për qytetarët që jetojnë në zona rurale të paarrishme dhe të largëta dhe përballen me rreziqe sociale, ekonomike dhe shëndetësore. Puna e ekipit të shërbimit mobil u prezantua si një shembull i suksesshëm në vendet e tjera të rajonit dhe pritet të kopjohet në Bosnje dhe Hercegovinë.

Foto: Falë dashamirësisë të Komunës së Koçanit





KOMUNA E  
ÇASHKËS

# KUJDESI PËR BREZAT E ARDHSHËM: NISMA E KOPSHTIT ÇASHKË

Prindërit në Komunën e Çashkës u përballën me rrezikun të mos kenë akses në shërbimet adekuate të kujdesit për fëmijët për shkak të kapacitetit të kufizuar të kopshtit të vetëm në zonë. Komuna e Çashkës në vitin 2018 ka shfrytëzuar infrastrukturën e një çerdheje nga Komuna e Velesit për të ofruar shërbime për kujdesin e fëmijëve për banorët e saj. Pas disa vitesh, kopshti arriti kapacitetin e plotë, në pamundësi për të përballuar kërkesat e banorëve. “Edhe pse dy fëmijët e mi janë në grupin ekzistues të kopshteve, tashmë është bërë problem që prindërit e tjerë nuk mund t’i regjistrojnë fëmijët e tyre sepse nuk ka vend për ta” - tha Ivana Stankovska, nënë nga Komuna e Çashkës.





Duke qenë se kopshti arriti kapacitetin e tij shpejt, ai rrezikoi perspektivat për kujdesin e fëmijëve të përballeshëm për brezat e ardhshëm të fëmijëve. Kjo situatë paraqiste sfida të rëndësishme për familjet, veçanërisht për nënat, që kanë nevojë për mbështetje gjatë ditës në kujdesin e fëmijëve. Nënat argumentuan se shërbimi i kujdesit për fëmijët i ofruar vetëm disa dhjetëra fëmijëve nuk ishte një opsion i zbatueshëm dhe i bënë thirrje Komunës së Çashkës për një zgjidhje të qëndrueshme.

Duke dëgjuar kërkesat e nënave, Komuna e Çashkës nisi procesin e themelimit të kopshtit të tyre “Bambi”. Që kjo të bëhet realitet, ambientet tashmë ekzistuese të Komunës janë rinovuar dhe riparuar në mënyrë që kopshti të funksionojë në vitin 2020 me marrjen e lejes së nevojshme nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Dy gra të papuna nga Komuna të cilat kanë marrë licencën për edukatore në kopsht janë punësuar për të ndihmuar në punën e përditshme të kopshtit. Fillimisht, objekti kujdesej për një grup të ndryshëm prej 2 deri në 6 vjeç, por mund të strehonte vetëm 20 fëmijë. Duke filluar nga viti 2023, Komuna dyfishoi me sukses kapacitetin e kujdesit ndaj fëmijëve dhe tani rreth 40 fëmijë mund të përfitojnë nga shërbimet e kopshtit.

Kopshtet shërbejnë për të fuqizuar gratë duke lehtësuar përgjegjësitë e kujdesit, duke mundësuar pjesëmarrje më të madhe të fuqisë punëtore, ndjekje arsimore dhe pavarësi financiare. Ato gjithashtu nxisin përfshirjen sociale mes fëmijëve përmes mundësive për rrjetëzim dhe ndërveprim, duke promovuar ndërtimin e marrëdhënieve pozitive dhe zhvillimin e aftësive sociale.

Foto: Falë dashamirësisë të Komunës së Çashkës



## KOMUNA E AERODROMIT

# FORCA! SPORT PËR TË GJITHË

Në zemër të Komunës së Aerodromit, klubi i hendbollit për femra Vardar – i themeluar në vitin 1961 – vazhdon të frymëzojë gjeneratat e ardhshme të sportisteve. Me një trashëgimi sukcesi, arritjet e Vardarit shërbejnë si një fener shprese për vajzat e panumërta në Aerodrom që ëndërrojnë të dalin në fushë, të veshin me krenari fanellën e skuadrës dhe të lënë gjurmë në sport. Megjithatë, pavarësisht nga triumfet, sportet e grave historikisht janë nënfinancuar dhe nën hije nga homologët e tyre meshkuj. Siç thekson Gordana Naceva Bosheva, sportiste dhe presidente e Vardarit: “Ndërsa skuadrat e meshkujve si skuadra jonë e basketbollit gëzojnë dukshmëri dhe mbështetje të fuqishme, sportet e femrave kanë ende nevojë për një simbol ikonë që përfaqëson forcën dhe potencialin e tyre”.

Foto: Falë dashamirësisë të Komunës së Aerodromit

Duke dëgjuar zërat e banorëve të saj dhe duke njohur potencialin e pashfrytëzuar në sportin rinor të femrave, Komuna e Aerodromit ndërhyri me veprim të vendosur. Ndërmjet vitit 2019 dhe 2021, Komuna ka ndarë 300 mijë denarë për përkrahje të klubeve të basketbollit dhe hendbollit të femrave. Kjo mbështetje, sipas Naceva Boshevës, ka qenë e dobishme: “Është inkurajuese të shohësh Komunën që i jep prioritet zhvillimit të sportit të femrave. Madje, për herë të parë në vitin 2022, Komuna lëshoi një thirrje publike për të mbështetur më tej klubet sportive të grave, një hap i paprecedentë. Investimi nuk u ndal tek mbështetja financiare. U prezantuan një sërë masash strategjike, nga sigurimi i vajzave me pajisje sportive dhe fanella cilësore deri te mbulimi i tarifave të anëtarësimi për atletet aspirante me prejardhje të paprivileguar. Këto nisma kanë transformuar jo vetëm skenën sportive, por edhe jetën e vajzave të reja në Aerodrom.



Në vitin 2019, përpjekjet e bashkisë dhanë fryte me krijimin e ekipit të saj të parë të basketbollit për femra. Sot, numri i klubeve sportive të grave vazhdon të rritet, duke pasqyruar pjesëmarrjen në rritje të vajzave të etura për të ndjekur ëndrrat e tyre atletike. Angazhimi i bashkisë për përfshirjen e barazisë gjinore në sport shkëlqen gjithashtu në njohjen vjetore të grave sportiste të shquara. Në vitin 2021, Komuna nderoi një yll të tillë në rritje, duke e njohur atë si një sportiste të suksesshme dhe model për brezat e ardhshëm.

Efektet e valëzuara të këtyre iniciativave janë të qarta, Aerodromi nuk po mbështet vetëm sportin e grave, por po ndryshon jetën dhe po krijon shtigje të reja për vajzat e reja për të shkëlqyer. Ndërsa Komuna vazhdon të thyejë barrierat, mesazhi është i qartë: Loja është duke u nisur—dhe këtë herë, është për të gjithë.



Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është një qasje transformuese për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e buxheteve që merr në konsideratë nevojat dhe përvojat e veçanta të grave dhe burrave dhe synon të promovojë barazinë gjinore përmes ndarjes së buxhetit dhe vendimeve të politikave. Gjatë dekadës së kaluar, përpjekjet e UN Women e kanë institucionalizuar BPGJ-në, duke përfshirë konsideratat gjinore në politikëbërjen dhe buxhetimin në nivel rajonal dhe kombëtar. Këto iniciativa kanë fuqizuar komunitetet e cenushme dhe kanë përmirësuar llogaridhënien në shpenzimet e buxhetit publik, duke kultivuar një grup ekspertësh të aftë të BPGJ-së.

Në fazën e parë të projektit “Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, UN Women bashkëpunoi me 31 komuna në Maqedoninë e Veriut për të përmirësuar jetën e grave dhe burrave me prejardhje të ndryshme. Duke udhëzuar dhe mbështetur qeveritë lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe gratë lokale, projekti ka lehtësuar hartimin, zbatimin dhe monitorimin e buxheteve dhe politikave të përgjegjshme ndaj gjinisë. Koordinatorët për Mundësi të Barabarta në komuna luajnë një rol kyç në promovimin e barazisë gjinore dhe integrimin gjinor në politikëbërjen lokale, me trajnime dhe mentorim nga UN Women.

Ky publikim ndan histori suksesi që nxjerrin në pah ndikimin e vërtetë të BPGJ-së në komunitete të ndryshme. Pesë histori nga komunat e mbështetura nga UN Women gjatë katër viteve të fundit theksojnë se si BPGJ ka trajtuar pabarazitë gjinore, duke përmirësuar shpërndarjen e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve për gratë, burrat dhe grupet e cenushme. Këto përvoja të drejtpërdrejta ofrojnë njohuri dhe frymëzim të vlefshëm për politikëbërësit, praktikuesit dhe avokatët e angazhuar për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave përmes buxhetimit dhe vendimmarrjes më gjithëpërfshirëse. Projekti tani do të zgjerojë ndikimin e tij, duke vazhduar punën me këto komuna dhe duke u zgjeruar për të përfshirë 10 të tjera në fazën e dytë.



Zhvillimi dhe publikimi i kësaj broshure ishte pjesë e projektit të UN Women “Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënese në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Faza 2” financuar nga Zvicra dhe programi “Promovimi i qeverisjes së përgjegjshme gjinore” në Republikën e Maqedonisë së Veriut” financuar nga Suedia.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara, ose të ndonjërit prej organizatave të lidhura me të, ose Zvicrës dhe Suedisë si donatorë.